



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQERIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIMË GJIROKASTER SH.A
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr Prot. Gjirokastër, më/...../2024

Shtojca 10

Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK

Drejtuar: Kreatx” me adrese Seli/Zyra Qendrore:
Tiranë, Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Godina 1, Shkalla 1, Zyra nr.2

Procedura e prokurimit/lotit: *Procedure e hapur e thjeshtuar*

Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-08392-06-06-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *“Mirembajtje programit te faturimit dhe fiskalizim i faturave”*

Fondi limit: 6,933,333 (gjashtemilion e nenteqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë)
Lekë pa Tvsh,

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike NR.30 Data 10
Qershor 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. ”Ilijana Qoku” NUIS: M21403009A me oferte ekonomike 0 leke pa tvsh
2. ”Infosoft systems” NUIS:J61820021C me oferte ekonomike 0 leke pa tvsh
3. ”Kreatx” NUIS: L12121023B me oferte ekonomike 5 950 000 leke pa tvsh

4. "Primus Albania NUIS:L42202028V me oferte ekonomike 5 199 999,75 leke pa tvsh

Shenim: OE "Primus Albania me NUIS:L42202028V ka marre pjese si bashkim operatoresh me OE Nexia AI Consulting NUIS L82210031Q ne kete procedure ku OE Primus Albania NUIS:L42202028V KA 60 % dhe OE Nexia AI Consulting me NUIS L82210031Q ka 40 %

Primus Albania NUIS:L42202028V

Nexia AI Consulting NUIS L82210031Q

U kualifikuan operatorët si me poshte:

1. "Kreatx" NUIS: L12121023B me oferte ekonomike 5 950 000 leke pa tvsh

U skualifikuan operatoresh si me poshte:

1. "Ilijana Qoku" NUIS: M21403009A me oferte ekonomike 0 leke pa tvsh

2. "Infosoft systems" NUIS:J61820021C me oferte ekonomike 0 leke pa tvsh

3. "Primus Albania NUIS:L42202028V me oferte ekonomike 5 199 999,75 leke pa tvsh

Arsyet e skualifikimit :

➤ Operatori ekonomik **Ilijana Qoku** nuk ka paraqitur ne SPE asnje dokument qe te vertetoje permbushjen e kritereve te kerkuara nga AK ne dokumentat standarte te tenderit.

➤ Operatori ekonomik **Infosoft Systems** nuk ka paraqitur ne SPE asnje dokument qe te vertetoje permbushjen e kritereve te kerkuara nga AK ne dokumentat standarte te tenderit.

1. Operatori ekonomik **Primus Albania NUIS:L42202028V bashkim operatoresh me Nexia AI Consulting NUIS L82210031Q**: Autoriteti kontraktor ne kuader te zbatimit te hapave ligjore te percaktuara ne LPP dhe Rregullat e Prokurimit publik u ka derguar kerkesen per sqarim ne te cilen kerkon nga ana juaj qe te paraqisni nje katalog,datasheet apo cdo dokument tjeter te leshuar nga prodhuesi i PDA ku te percaktohen ne menyre te qarte specifikimet teknike per pajisjet PDA qe do te ofertoni. Ne kthim pergjigjen tuaj konstatohet nje hezitim per depozitimin e datasheet ose katalogeve per pajisjet PDA qe ju vete keni zgjedhur te ofertoni. Referuar kthim pergjigjes tuaj ku ju citoni qe ne si AK nuk kemi kerkuar kataloge, datasheet qe te dorezohen ju bejme me dije qe referuar vendimeve te ndryshme te KPP nje kerkese e tille eshte rrezuar duke u konsideruar si kriter diskriminues. AK ka vepruar sipas ligjit per tju kerkuar informacion te detajuar per PDA qe ju vete keni zgjedhur te ofertoni. Duke patur parasysh qe ligji shprehimisht shprehet ne parimet e tij qe eshte ne tagrin e operatorit ekonomik qe ti demostroje AK qe ka aftesine per te permbushur kriteret dhe specifikimet e percaktuara, ju si BOE nuk na keni vendosur ne dispozicion informacionin

e kerkuar ne kuader te shqyrtimit sa me te plote te dokumentacionit te depozituar per kriterin 2.3.4 dhe specifikimet teknike te parashikuara per pajisjet PDA. Per sa cituam me lart OE skualifikohet sepse nuk ka permbushur detyrimin ligjor per ti dhene AK informacionin e nevojshem te kerkuar kundrejt parashikimeve ligjore.

2. Autoriteti kontraktor ne kuader te zbatimit te hapave ligjore te percaktuara ne LPP dhe Rregullat e Prokurimit publik u ka derguar kerkesen per sqarim ne te cilen kerkon nga ana juaj qe te paraqisni dokumentacionin i cili te beje te mundur verifikimin nga ana e AK qe partneriteti per permbushjen e pikes 2.3.6 eshte i vlefshem ose nje link ne internet ku te figuroje qe Nexia AI Consulting eshte partner zyrtar i ofruesit te sherbimit cloud Digitalocean. Referuar kthim pergjigjes tuaj konstatohet qe ne asnje moment nuk na jepet informacioni i kerkuar nga ana jone dhe ne kete menyre verifikimi per vlefshmerine e ketij partneriteti eshte i pamundur. Duke patur parasysh qe ligji shprehimisht shprehet ne parimet e tij qe eshte ne tagrin e operatorit ekonomik qe ti demostroje AK qe ka aftesine per te permbushur kriteret dhe specifikimet e percaktuara, ju si BOE nuk na keni deshmuar te provoni vlefshmerine e ketij partneriteti dhe rrjedhimisht nuk keni permbushur kriterin 2.3.6.

3. BOE i perbere nga Primus Albania Shpk dhe Nexia Consulting AI Shpk nuk ka permbushur kriterin e parashikuar ne piken 2.3.5 *“App Mobile i lexuesve duhet te jete i certifikuar per pajisjen PDA te ofertuar nga prodhuesi i pajisjes. Per te vertetuar kete kete duhet te dorezoje dokumentin e leshuar nga prodhuesi me emrin e APP mobile dhe PDA per te cilen leshohet ky certifikim”*.

Referuar dokumentacionit te paraqitur ne SPE BOE nuk ka paraqitur dokumentacionin i cili te vertetoje qe APP Mobile qe do te ofertoje ne kete procedure eshte i certifikuar per pajisjet PDA qe do te ofertohen dhe rrjedhimisht BOE nuk ka permbushur nje nga kerkesat kryesore te parashikuara ne DST.

4. BOE i perbere nga Primus Albania Shpk dhe Nexia Consulting AI Shpk nuk ka permbushur kriterin per te paraqitur sigurimin e ofertes sipas kerkesave ne DST. Me konkretisht gjate shqyrtimit te sigurimit te ofertes se paraqitur me Nr 0603300440057366 AK ka konstatuar qe ky sigurim nuk eshte ne perputhje me kerkesat ne DST. Keto mosperputhje jane si meposhte :

- Data e sigurimit te ofertes eshte data 30.07.2024 dhe jo data 01.08.2024 qe eshte dhe afati perfundimtar i pranimit te ofertave. Data tregon se kur sigurimi fillon vlefshmerine e tij.
- Vlera e sigurimit te ofertes te paraqitur nga BOE eshte 138,667 (Njeqind e tridhete e tete mije e gjashteqind e gjashtedhete e shtate) lek , ndersa vlera e sakte qe sigurimi i ofertes duhet te kete eshte 138,666.67 (Njëqind e tridhjetë e tetë mije e gjashteqind e gjashtëdhjetë e shtatë pik gjashtëdhjetë e shtatë)leke, vlere e cila eshte saktuar pas

ankimimit administrativ dhe eshte percaktuar me ane te shtojces nr. 4 date 23.07.2024 te publikuar ne SPE konform parashikimeve ligjore.

- Afati i sigurimit te ofertes te parashikuar ne DST eshte 150 dite, por ne ndryshim nga ky afat BOE ka paraqitur sigurimin e ofertes me afat 152dite.

Rrjedhimisht referuar konstatimeve te meposhtme sigurimi i ofertes nuk eshte i sakte sipas parashikimeve ligjore dhe dokumentave standarte te tenderit.

- BOE i perbere nga Primus Albani Shpk dhe Nexia Consulting Al Shpk nuk ka permbushur kriterin 2.3.3 per disponimin e punonjesve qe do te angazhohen ne kete projekt sipas perqindjes se deklaruar ne marreveshjen per bashkimin e shoqerive te mesiperme te ngarkuar ne SPE. AK ne DST ka parashikuar kriterin 2.3.3 i cilit thote :

“Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar, per 3 (tre) muajt e fundit nga data e shpalljes se procedures, punonjes te diplomuar ne fushen e IT si inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj. qe kane certifikata si me poshte:

a. Te pakten 3 punonjes te certifikuar ne implementim ose zhvillim te zgjidhjes se ofruar ku te pakten 1 eshte i certifikuar per sistemin e faturimit ekzistues Flare Billing ose ekuivalent, te pakten 1 eshte i certifikuar per moduln e leximeve te ofruar, te pakten 1 eshte i certifikuar per moduln e fiskalizimit te ofruar

b. Te pakten 1 punonjes te çertifikuar per zhvillimin ose administrimin e bazes se te dhenave qe perdor zgjidhja softwerike e ofruar

c. Te pakten 1 (nje) punonjes të çertifikuar per SOACP ose ekuivalent..

d. Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per sigurine ne Cloud

e. Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per menaxhimin e sherbimeve IT (ITIL) ose ekuivalente”

Operatoret ekonomike pjese e BOE kane paraqitur formularet permbledhes te Vetedeklarimit ne te cilin jane shprehur qe disponojne punonjesit me certifikimet perkatese sipas kerkesave per permbushjen e objektit te kontrates dhe me konkretisht referuar ketyre vetedeklarimeve jane shprehur se si pjese e BOE i plotesojne certifikimet si meposhte:

| Certifikimi i kerkuar | OE qe ploteson kriterin |
|---|--------------------------------|
| Te pakten 1 eshte i certifikuar per sistemin e faturimit ekzistues Flare Billing ose ekuivalent | Primus Albania Shpk |
| Te pakten 1 eshte i certifikuar per moduln e leximeve te ofruar | Primus Albania Shpk |
| Te pakten 1 eshte i certifikuar per moduln e fiskalizimit te ofruar | Nexia Consulting Al |
| Te pakten 1 punonjes te çertifikuar per zhvillimin ose administrimin e bazes se te dhenave qe perdor zgjidhja softwerike e ofruar | Nexia Consulting Al |

| | |
|---|---------------------|
| Te pakten 1 (nje) punonjes të çertifikuar per SOACP ose ekuivalent. | Nexia Consulting Al |
| Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per sigurine ne Cloud | Nexia Consulting Al |
| Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per menaxhimin e sherbimeve IT (ITIL) ose ekuivalente | Primus Albania Shpk |

Referuar vetedeklarimeve konstatohet qe ne 7 certifikime totale qe AK ka kerkuar 3 prej tyre plotesohen nga OE Primus Albania Shpk e cila e perkthyer ne perqindje perben 42.85% te certifikimeve te kerkuara, ndersa OE Nexia Consulting Al ploteson 4 prej certifikimeve te kerkuara e cila e perkthyer ne perqindje perben 57.15% te certifikimeve te kerkuara. Plotesimi i kriterit te mesiperm bie ndesh me marreveshjen e bashkepunimit te ngarkuar ne SPE nga BOE. Me konkretisht ne marreveshjen per bashkimin e shoqerive Neni 4 “Perqindja e pjesemarrjes ne bashkimin e shoqerive” eshte parashikuar qe Primus Albania Shpk do te mbuloje 60% te kontrates dhe Nexia Consulting Al do te mbuloje 40% te kontrates. Pra sic mund te konstatohet lehtesisht perqindja sipas se ciles pjesetaret e BOE kane permbushur kriterin 2.3.3 nuk eshte e njejte me perqindjen te cilen e kane deklaruar ne marreveshjen e bashkepunimit, cka ben rrjedhimisht qe kriteri te mos jete permbushur sipas marreveshjet qe operatoret ekonomike vete kane deklaruar.

6. AK ka konstatuar qe OE i perbere nga Primus Albania Shpk dhe Nexia Consulting Al Shpk nuk kane plotesuar oferten ekonomike ne proporcion me perqindjen e deklaruar ne marreveshjen e bashkepunimit ne te cilen eshte parashikuar qe Primus Albania Shpk do te mbuloje 60% te kontrates dhe Nexia Consulting Al do te mbuloje 40% te kontrates. Me konkretisht e ne marreveshjen e ngarkuar ne SPE, BOE ka parashikuar realizimin e sherbimeve sipas tabelës se meposhtme :

| Sherbimi | Përshkrimi i sherbimi | Primus Albania Shpk | Nexia Consulting AL |
|----------|--|---------------------|---------------------|
| 1 | Dorezimi i pajisjeve mobile PDA dhe venia ne pune e tyre | X | |
| 2 | Upgrade i sistemit ekzistues Flare Billing | X | |
| 3 | Vendosja e modulit te leximit | X | |
| 4 | Vendosja e modulit te fiskalizimit | | X |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 5 | Licensa perdorimi, mirembajtje ne cloud e sistemit te upgraduar me te gjithë funksionalitetet, integrimet, me modulet e reja, pajisjet PDA. | X | X |
|---|---|---|---|

Tabela e mesiperme sipas vete marreveshjes se operatoreve pjesmarres ne BOE tregon dhe ndarjen e detyrave qe do te kishte secili pjesemarres ne perputhje me perqindjen e cila eshte parashikuar.

Ne reference te tabelës se mesiperme AK mori ne shqyrtim oferten ekonomike te paraqitur ne SPE, per te evidentuar nese ofertimi ishte ne perputhje me perqindjen te cilen operoret ekonomike kishin deklaruar apo jo. Oferta ekonomike i ka te ndara zerat sipas tabelës meposhte :

| Sherbimi | Pershkrimi i shërbimi | Sasia | Cmimi per njesi | Cmimi total |
|----------|---|-------|-----------------|-------------|
| 1 | Dorezimi i pajisjeve mobile PDA dhe venia ne pune e tyre | 5 | 138,000 | 690,000 |
| 2 | Upgrade i sistemit ekzistues Flare Billing | 1 | 117,999.75 | 117,999.75 |
| 3 | Vendosja e modulit te leximit | 1 | 120,000 | 120,000 |
| 4 | Vendosja e modulit te fiskalizimit | 1 | 1,920,000 | 1,920,000 |
| 5 | Licensa perdorimi, mirembajtje ne cloud e sistemit te upgraduar me te gjithë funksionalitetet, integrimet, me modulet e reja, pajisjet PDA. | 12 | 196,000 | 2,352,000 |

Gjate shqyrtimit ofertes ekonomike konstatohet qe per piken 4 “Vendosja e modulit te fiskalizimit” BOE ka ofertuar shumen prej 1,920,000 (Nje milion e nenteqind e njezet mije) leke pa tvsh dhe kjo shume e ofertuar ne vetvete perben 36.9 % te ofertes totale. Po ti referohemi tabelës se ndarjes se sherbimeve ne kontraten e bashkepunimit kuptojme qe kete ze oferte ka marre persiper qe ta realizojne ne masen 100% OE Nexia AI Consulting shpk.

Per sa i perket pikes 5 “Licensa perdorimi, mirembajtje ne cloud e sistemit te upgraduar me te gjithë funksionalitetet, integrimet, me modulet e reja, pajisjet PDA” BOE ka ofertuar shumen prej 2,352,000 (Dy milion e treqind e pesedhete e dy mije) leke pa tvsh.

Po ti referohemi tabelës së ndarjes së shërbimeve në kontratën e bashkëpunimit kuptojmë që këto oferta kanë marrë persiper që ta realizojnë të dy pjesëtarët e BOE sipas ndarjes së parashikuar në marrëveshje, pra 60% Primus Albania Shpk dhe 40% Nexia Consulting AL Shpk. Duke i konvertuar në vlera reale këto përqindje për zërin 5 të ofertes dalim në përfundim që për këto shërbime Primus Albania Shpk ka ofertuar shumën prej 1,411,200 (Një milion katërqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind) dhe Nexia Consulting AL Shpk shumën prej 940,800 (Nëntëqind e dyzet mijë e teteqind) lekë pa TVSH.

Referuar sa cituam më lart në mbështetje të analizës financiare të kryer dhe gjithashtu mbështetur në përqindjet e përcaktuara dhe tabelën e shërbimeve që janë pjesë e marrëveshjes së përbashkët të ngarkuar në SPE, AK konstaton që operatorët ekonomikë pjesë e BOE kanë ofertuar vlerat si mëposhtë :

| PRIMUS ALBANIA SHPK | |
|--|------------------|
| Sherbimi | Vlera |
| Dorezimi i pajisjeve mobile PDA dhe venia në punë e tyre | 690,000 |
| Upgrade i sistemit ekzistues Flare Billing | 117,999.75 |
| Vendosja e modulit të leximit | 120,000 |
| Licensa përdorimi, mirëmbajtje në cloud e sistemit të upgraduar me të gjithë funksionalitetet, integrimet, me modulet e reja, pajisjet PDA | 1,411,200 |
| Totali | 2,339,200 |
| Perqindja e ofertimit Primus Albania Shpk referuar ofertes totale prej 5,199,999.75 lekë pa TVSH | 44.98 % |

| NEXIA CONSULTING AL SHPK | |
|--|------------------|
| Sherbimi | Vlera |
| Vendosja e modulit të fiskalizimit | 1,920,000 |
| Licensa përdorimi, mirëmbajtje në cloud e sistemit të upgraduar me të gjithë funksionalitetet, integrimet, me modulet e reja, pajisjet PDA | 940,800 |
| Totali | 2,860,800 |
| Perqindja e ofertimit Nexia Consulting Al Shpk referuar ofertes totale prej 5,199,999.75 lekë pa TVSH | 55.02 % |

Pra sic mund të evidentohet nga e gjithë analiza e kryer konstatohet që BOE i përbërë nga Primus Albania Shpk dhe Nexia Consulting Al Shpk, rezulton që oferta ekonomike e paraqitur bie në kundërshtim me përcaktimet e vetë operatorëve ekonomikë të cilët kanë paraqitur marrëveshjen e përbashkët në këtë procedurë. Me konkretisht në marrëveshjen për bashkimin e shoqërive Neni 4 “Përqindja e pjesëmarrjes në bashkimin e shoqërive” është parashikuar që Primus Albania Shpk do të mbulojë 60% të kontratës dhe Nexia Consulting Al do të mbulojë 40% të kontratës, por realisht referuar konstatimeve të AK gjatë analizimit të ofertes ekonomike dhe kontratës së bashkëpunimit AK ka konstatuar

qe perqindja eshte e ndryshme nga ajo cfare eshte deklaruar. Perqindja reale sipas tabelave te mesiperme bazuar ne oferten ekonomike eshte 44.98% operatori ekonomik Primus Albania Shpk dhe 55.02 % Nexia Consulting AL shpk.

7. AK konstaton qe BOE nuk disponon punonjesit e nevojshem sipas zerave qe eshte marre persiper nga secili pjestar per realizimin e sherbimeve objekt kontrate. Me konkretisht ne marreveshjen e bashkepunimit te ngarkuar ne SPE nga BOE i perbere nga Primus Albania Shpk dhe Nexia Consulting Al Shpk eshte percaktuar tabela per zerat e sherbimeve qe do te mbuloje secili pjestar ne kete procedure, si meposhte :

| Sherbimi | Përshkrimi i sherbimi | Primus Albania Shpk | Nexia Consulting AL |
|----------|---|---------------------|---------------------|
| 1 | Dorezimi i pajisjeve mobile PDA dhe venia ne pune e tyre | X | |
| 2 | Upgrade i sistemit ekzistues Flare Billing | X | |
| 3 | Vendosja e modulit te leximit | X | |
| 4 | Vendosja e modulit te fiskalizimit | | X |
| 5 | Licensa perdorimi, mirembajtje ne cloud e sistemit te upgraduar me te gjithe funksionalitetet, integrimet, me modulet e reja, pajisjet PDA. | X | X |

-Per sa i perket pikes 2 *“Upgrade i sistemit ekzistues Flare Billing”* eshte parashikuar qe ky sherbim do te realizohet ne masen 100% nga operatori Primus Albania Shpk. Sipas specifikimeve teknike Flare Billing nder funksionalitet qe ka jane edhe web sherbimet per integrimet e ketij sistemi me sisteme te tjera sic jane institucionet financiare banke dhe jo banke qe sic jane shpjeguar ne termat e references jane shume te rendesishme per aktivitetin ekonomik te shoqerise. Ashtu sic eshte kerkuar ne specifikimet teknike, OE fitues duhet te beje upgrade kodin sistemin ekzistues duke perfshire teknologjite nga te cilat perbehet dhe funksionet nga te cilat perbehet me paketa software origjinale. Nder komponentet e sistemit jane edhe web sherbimet te cilat pervec se do te impaktohen nga upgrade qe do te kryhet, ato do te duhet te instalohen e konfigurohen nga OE kur sistemi te vendoset ne Cloud e ofruar nga OE. Aktivitetet qe duhet te kryhen per te bere te mundur upgrade, instalim, konfigurim dhe implementim te plote te web sherbimeve, duhet te kryhen nga punonjes te certifikuar sipas kerkeses se kapaciteteve teknike *“c. Te*

pakten 1 (nje) punonjes të certifikuar per SOACP ose ekuivalent” ose ekuivalent. Sipas ofertës suaj kete punonjes e ve ne dispozicion shoqeria Nexia Consulting AL shpk . Sipas ofertimit ekonomik, qe perfshihet ne zerin 2 Upgrade i sistemit ekzistues Flare Billing, eshte marre persiper nga Primus Albania Shpk. Referuar kontrates suaj te bashkepunimit dhe shtojcave te vetedeklarimit, shoqeria Primus Albania Shpk nuk ka kapacitetin profesional per te permbushur sherbimin e marre persiper.

- Per sa i perket pikes 3 *“Vendosja e modulit te leximit”* eshte parashikuar qe ky sherbim do te realizohet ne masen 100% nga operatori Primus Albania Shpk. Sipas specifikimeve teknike ky modul leximesh, duhet te siguroje komunikim nepermjet web sherbimeve mes App mobile dhe software te instaluar ne cloud. Keto aktivitete te instalimit, konfigurimit te web sherbimeve kryhen nga specialiste te certifikuar sipas kerkeses per plotesimin e kapaciteteve teknike *“c. Te pakten 1 (nje) punonjes të certifikuar per SOACP ose ekuivalent”*. Bazuar ne kontraten tuaj te bashkepunimit kete ze e ka marre persiper Primus Albania Shpk . Por sipas formulareve te vetedeklarimit, punonjesi qe ploteson *“c. Te pakten 1 (nje) punonjes të certifikuar per SOACP ose ekuivalent”* eshte punonjes i Nexia Consulting Shpk.. Referuar kontrates suaj te bashkepunimit dhe shtojcave te vetedeklarimit, shoqeria Primus Albania Shpk nuk ka kapacitetin profesional per te permbushur sherbimin e marre persiper.

- Per sa i perket pikes 5 *“Licensa perdorimi, mirembajtje ne cloud e sistemit te upgraduar me te gjithë funksionalitetet, integrimet, me modulet e reja, pajisjet PDA”* eshte parashikuar qe ky sherbim do te realizohet nga te dy operatoret pjesmarres ne BOE pa percaktuar perqindjen e angazhimit per kete ze qe do te thote se te dy operatoret do te kryejne te gjithë aktivitetet se bashku. Si pasoje e faktit qe nuk eshte percaktuar perqindja e angazhimit per kete ze AK konstaton qe ne reference te specifikimeve teknike dhe sherbimeve qe duhet te kryhen per permbushjen e kesaj pike, Nexia Consulting AL shpk nuk ka punonjes te certifikuar per *“a. ...te pakten 1 eshte i certifikuar per sistemin e faturimit ekzistues Flare Billing ose ekuivalent, te pakten 1 eshte i certifikuar per modulimin e leximeve te ofruar...; e. Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per menaxhimin e sherbimeve IT (ITIL) ose ekuivalente; ”* dhe Primus Albania Shpk nuk ka punonjes te certifikuar per *“b. Te pakten 1 punonjes te certifikuar per zhvillimin ose administrimin e bazeve se te dhenave qe perdor zgjidhja softwerike e ofruar; d. Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per sigurine ne Cloud; c. Te pakten 1 (nje) punonjes të certifikuar per SOACP ose ekuivalent; ”*

Per keto arsye BOE nuk ka kapacitete te nevojshme te permbushje te gjithë detyrat qe lidhen me zerin e ofertuar bazuar ne kontraten e bashkepunimit qe eshte dorezuar ne SPE.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë ” Kreatx” me adrese **Seli/Zyra Qendrore:Tiranë, Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Godina 1, Shkalla 1, Zyra**

nr.2 se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 5 950 000(pese milion e nentqind e pesedhete mije) leke pa TVSH me NIPT : L12121023B / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Gentian LLOGO